

Konkluzionet e përbashkëta Kthimi ne Ferizaj

7 Shtator 2005

Të gjitha palët janë te pajtimit se ka potencial per rritjen e kthimit ne qendrën e qytetit të Ferizajit.

Të gjitha palët e refuzojnë përdorimin e dhunës kunder cfaredo personi dhe u bëjnë thirrje të gjithë personave përgjegjës që t'i shtojnë përpjekjet për hetimin e këtyre rasteve. Thirren të gjithë qytetarët që të mos bëjnë paragjykime para hetimeve duke bërë supozime për krimin.

Të gjitha palëve ju vie keq që Kryetari i komunës, Zëvendës Kryetari dhe Kryeshefi I Ekzekutivit të Shtërpces nuk kanë qenë në mbledhje që ti inkurajojnë ata të hyjnë në dialog serioz me autoritetet në Ferizaj. Bashkëpunimi dhe dialogu ne mes te udhëheqësve të të dyja komunave duhet të filloj. Këta persona kanë obligim ndaj qytetarëve që t'i perfaqesojne ata në të gjitha mbledhjet e rëndësishme që kanë të bëjnë me bashkëpunimin në mes të dy komunave.

Të gjitha palët janë te pajtimit që komuna ka bere përpjekje të mira per t'i mirepritur ish-qytetarëve dhe zotohen qe te forcojne kthimin.

1. Është e mundshme që të forcohet kthimi në qendër të Ferizajit në mënyrë të sigurt. Zyrtari për kthim i Shtërpces do të punojë së bashku me Shoqatën e personave të zhvendosur dhe me Grupet Punuese Komunale për Kthim që si faqe e pare e kthimit te mundshem të identifikohet vendi i mundshem i kthimit ne qendren e qytetit me perqendrim ne 1-3 rrugë ku Serbët dëshirojne të kthehen. Komuna do të jetë përgjegjëse që të krijojë një ambient tolerant dhe mirëseardhës.
2. Është me rëndësi që grupet punuese komunale të kenë një list të perbashket dhe te hollesishme te familjeve të cilat dëshirojne të kthehen në vendet e lartë cekura. Zyrtari për Kthim i Shtërpces do te siguroje këtë liste në të shkruar për mbledhjen e ardhshme.
3. Të dy Zyrtarët Komunal për Kthim duhet të takohen më shpesh dhe të shkëmbejnë informata. Zyrtari Komunal për Kthim i Ferizajit e mirepret thirrjen për të marrur pjesë ne mbledhjen e ardhshme te grupeve punuese komunale për kthim në Shtërpce.

4. Komiteti për Komunitete do të zhvillojë së bashku me personat e zhvendosur disa propozime për ndonjë manifestim shoqëror për personat e zhvendosur dhe ish-fqinjët. Komuna do t'i mbështet këto nisma.
5. Është me rëndësi që përfaqësuesve të personave të zhvendosur t'ju sigurohet transport i rregullt në mes dy komunave. Të gjithë e mirëpresin gatishmerinë e UNMIK-ut t'ju siguroj transport atyre. Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe qeveria e komunës së Ferizajit poashtu kanë ofruar transport.
6. Të gjitha palët e mbështesin linjen e rregullt të autobusit ndërmjet dy komunave. Do të ishte mirë që beneficionet e kësaj nismeje të shpallen gjërisht. Për tre muaj komuna e Shtërpces dhe e Ferizajit do t'i paguajnë shpenzimet e autobusit. Në ndërkohë Ministria për Komunitete dhe Kthim është duke marrë në konsideratë që të marrë përsipër këtë autobus dhe ta bëjë atë me punetore shumë etnike. Të gjithë mirëpresin intervenimin e Ministrisë në këtë çështje.
7. UNMIK-u i ka regjistruar ankesat e personave të zhvendosur për riposëdimin e pronave të tyre dhe pajtohet që për këtë çështje të takohet ndaras me personat e zhvendosur. Qeveria komunale është e gatshme që të pranojë ankesat në mënyrë të shkruar që kanë të bëjnë me lokale afariste ose pronat tjera dhe do të ofrojë ndihmë ose dokumentet e nevojshme. Kryeshefi i ekzekutivit ka pranuar që t'i pranojë ankesat e tyre.
8. Serbët zhvendosur kanë interes në vizitat shko dhe shiko por kanë disa ankesa për procesin aktual. Të gjitha palët u bëjnë thirrje organizatave ndërkombëtare dhe zyrtarëve përgjegjës që t'i përmirësojnë dhe t'i lehtësojnë vizitat e rregullta.
9. Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet që të marrë pjesë në grupet punuese komunale për kthim.
10. Të gjitha komunitetet kanë problem me humbjen e dokumenteve që kanë të bëjnë me arsimim, punë dhe pension. Komiteti i Komuniteteve është pajtuar që të jetë pikë qendrore për këtë çështje dhe ta shqyrtojë atë, i mbështetur nga UNMIK-u dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim. Ku të jetë e mundur, të leshohen dokumentet e reja, dhe nëse jo, Ministria do të shqyrtojë propozime tjera për zgjidhjen e kësaj çështjeje.
11. CSSP do të ndikojë tek donatorët ndërkombëtarë për projektet që mbështesin përmirësimin e kontaktit dhe kthimin të cilat zhvillohen bashkërisht nga të dyja komunat.
12. CSSP e mirëpret një raport nga të dyja komunat lidhur me përparimin në këto çështje deri më 1 Dhjetor 2005.

Konkluzionet janë pajtuar në koncenzus.

Pjesëmarrësit

Z. Faik Grainca	Kryetari i Komunës (Ferizaj)
Z. Sabit Krasniqi	Kryeshefi I Ekzekutivit (Ferizaj)
Z. Hyzri Hasani	Zyra e Komuniteteve (Ferizaj)
Z. Josuf Avdiu	Zyra e Komuniteteve (Ferizaj)
Znsha. Xhevahire Dervishi-Rexhepi	Zyrtari Komunal për Kthim (Ferizaj)
Z. Dragan Kukurekovic	Këshilltar i Ministrit, Ministria për Komunitete dhe Kthim
Z. Albert Zeca	Zëvendës i Këshilltarit, Ministria për Komunitete dhe Kthim
Znjsha. Spomenka Kojadinovic	Zyrtari për Komunal për Kthim (Shtërpçë)
Znjsha. Gordana Ristic	Kryetari i personave të zhvendosur (Shtërpçë)
Z. Dragomir Dordvice	Përfaqësues i personave të zhvendosur (Strpce / Shtërpçë)
Z. Gafur Imeri	Zëvendës Kryetari i Komunës (Ferizaj/ Uroševac)
Z. Dharam Pal	Përfaqësuesi i UNMIK-ut ne Komunë (Ferizaj/ Uroševac)
Dr. Christian Schwarz-Schilling	Ndërmjetësues kryesor, CSSP
Dr. Dieter Wolkewitz	Ndërmjetsues, CSSP
Dr. Juan Diaz	Ndërmjetsues, CSSP
Eva Malisius	Asistent ndërmjetsues, CSSP